

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

2Alba@Invest sh.p.k.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më **04/07 /2023**, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **2Alba@Invest sh.p.k.** këtu e në vazhdim referuar si “Shoqëria”.
2. Shoqëria fiton personalitet juridik pasi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar Tregtar.
3. Themelues të shoqërisë janë:
Dritan Xhaferi, datëlindja 11.04.1972, me numër ID 035681956 dhe numër personal H20411110U
Shpëtim Dulaj, datëlindja 24.03.1973, me numër ID 034600015 dhe numër personal H30324062N

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve dhe veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë sipas ligjit, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me objekt Sipërmarrje në fushën e investimeve të pasurive të patundshme.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

- Për një afat të pacaktuar

Neni 4:

Selia

- a) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Mujo Ulqinaku, Nr. 22, Kati 1, Njesia 10, Tiranë
- b) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronike është si vijon: suela.dulaj17@gmail.com
Tel. +355 69 405 2384

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është **2,000,000 Lek**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Partneri themelues 1 - 2Alba@Invest sh.p.k Dritan Xhaferi, Pronar i një kuote me vlerë të përgjithshme 1,000,000 Leke që përbën 50% të kapitalit bazë të shoqërisë.

Partneri themelues 2 - 2Alba@Invest sh.p.k Shpëtim Dulaj, Pronar i një kuote me vlerë të përgjithshme 1,000,000 Leke që përbën 50% të kapitalit bazë të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë *në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin* dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- (1) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- (2) shitblerjes;
- (3) trashëgimisë;
- (4) dhurimit;
- (5) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Ortakët e Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes sipas ligjit. Pjesët e kapitalit themeltar duhet ti ofrohen për shitje ortakëve të shoqërisë me përparësi, në përputhje me ligjin. Nëse ortakët e Shoqërisë nuk shprehin interes për blerjen e kuotave ato mund ti ofrohen lirisht palëve të treta jashtë shoqërisë.

Në rast se kuotat e kapitalit themeltar i shiten njërit nga ortakët themelues këta kanë të drejtën e shlyerjes së çmimit të kuotës me këste të barabarta mujore brenda një afati 5 vjeçar nga data e shitjes.

KREU III

Asambleja e Përgjithshme, Administratorët

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- (1) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- (2) ndryshimet e statutit;
- (3) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- (4) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- (5) përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin;



- (6) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- (7) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- (8) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- (9) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- (10) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- (11) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- (12) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprjë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

9.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, për të miratuar inventarin dhe bilancin, raportin e administratorit dhe raportin e kontabilistit publik të certifikuar.

9.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga çdo person tjetër në bazë të një përfaqësuesi me shkrim. Në çdo rast, përfaqësimi mund të jepet vetëm për një Mbledhje të Përgjithshme. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme për të shprehur mendimin e tij dhe për të votuar në raport me numrin e kuotave që zotëron në kapitalin e shoqërisë.

9.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose nga ortaku që zotëron të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme duhet të thirret me postë të rekomanduar ose me postë elektronike me dëshmi të marrjes dërguar ortakëve dhe, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike përpara mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë informacion për llojin e Mbledhjes së Përgjithshme, rendin e ditës që do të diskutohet, vendin, orën dhe ditën, thirrjen e parë dhe të dytë.

Mbledhja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend të ndryshëm nga selia e regjistruar, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbahet në thirrjen e parë për shkak të mungesës së kuorumit të parashikuar në nenin 10, Asambleja e Përgjithshme e thërret sërish mbledhjen me të njëjtin rend dite të propozuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

9.4 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe me audio ose video konferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen nga kryesuesi dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktive në të. Pas verifikimit të këtyre kërkesave, të cilat duhet të paraqiten në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbajtur në vendin ku janë të pranishëm Kryetari dhe Sekretari i Mbledhjes.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë **më shumë se 50 për qind të kuotave.**

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, ajo mund të marrë vendime të



vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50 për qind te kuotave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- (2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator Shoqërisë
- (3) Të dhënat e identifikimit

Suela Dulaj , Atësia Hamdi, Lindur ne Tiranë, Banues ne Tiranë ne adresën adresën Rr. Mujo Ulqinaku, H. 1, Ap. 54, Tiranë	Numër ID: 034642132 Numer Personal: H45601257Q
--	---

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Administratori detyrohet:

1. Të Posaçme:

- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a. u kthen ortakëve kontributet;
 - b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR, EKSPERTËT

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezulttit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese. Nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, ajo priset në bazë të vendimeve të përcaktuara nga pika 5 e nenit 43, pika 5 e nenit 99, dhe pika 5 e nenit 187, të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, dhe çregjistrohet nga regjistri tregtar, sipas nenit 51, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, pa iu nënshtruar procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara ne ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit. Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do te jetë kompetente Gjykata e Juridiksionit te Përgjithshëm Tiranë

Nënshkrimet e Ortakëve

<p>Emër, Mbiemër, Firmë, Dritan Xhaferi</p> 	<p>Emër, Mbiemër, Firmë, Shpëtim Dulaj</p> 
--	--